

UNIVERSITETI PUBLIK “HAXHI ZEKA” PEJË

STATUTI I PËRKOHSHËM

2011

## STATUTI I PËRKOHSHËM I UNIVERSITETIT PUBLIK "HAXHI ZEKA" PEJË

### Pjesa I: Baza Ligjore

#### Neni 1

1. Vendimi i Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 434/01 B të datës 14.11.2011 për themelimin e Universitetit Publik "Haxhi Zeka" në Pejë;
2. Universiteti Publik "Haxhi Zeka" Pejë themelohet si institucion arsimor dhe i kërkimit e shkencës, i cili do të jep diploma dhe grada shkencore deri në nivelin e doktoratës.

### Pjesa II: Dispozitat e Përgjithshme

#### Neni 2

Universiteti Publik "Haxhi Zeka" Pejë (tani e tutje referohet si 'Universiteti') themelohet në Republikën e Kosovës si institucion publik i arsimit të lartë, i cili angazhohet në mësim dhe kërkime dhe ka këto objektiva vijuese:

1. të jetë qendër udhëheqëse për avancimin e dijes, mendimit dhe shkollimit në Kosovë;
2. të luajë rol udhëheqës në zhvillimin arsimor, shkencor, kulturor, social dhe ekonomik të Kosovës;
3. të ndihmojë në procesin e ngriljes së demokracisë qytetare;
4. të synojë që të krijojë dhe mbështhesë standardet e larta në mësim dhe kërkime;
5. të krijojë shfrytëzimin sa më efektiv të burimeve që i ka në dispozicion;
6. të merrë pjesë plotësisht në komunitetin regional dhe ndërkombëtar të arsimit të lartë;

#### Neni 3

1. Universiteti do të jetë institucion i hapur për të gjithë, në baza të paanësise dhe meritës, pavarësisht përkatësisë etnike;
2. Fushat kryesore të përgjegjësisë të Universitetit të Pejës janë mësimi, hulumtimi, konsulenca dhe shërbimi i komunitetit.

#### Neni 4

Stafi dhe studentët e Universitetit gjëzojnë lirinë e asociacionit dhe shprehjes brenda strukturave të parapara me këtë statut.

#### Neni 5

1. Selia e Universitetit në Pejë është në rrugën UÇK (ish kazemat ) p.n., 30000 Pejë, Republika e Kosovës
2. Universiteti e ka vulen e vet te rrumbullaket dhe katrore, e cila përgatitet në bazë të vendimit të Këshillit të Përkoħshem Drejtues
3. Universiteti ka logon dhe flamurin e vet, të cilat do të nxirren dhe përdoren me vendim të Këshillit të Përkoħshem Drejtues

## Neni 6

Data e themelimit të Universitetit është 14 nëntor 2011.

## Neni 7

Universiteti është person juridik me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

## Neni 8

1. Universiteti në themelim, punën dhe aktivitetin e vet, do ta bazojë brenda legjislacionit që e rregullon sferën e shkollimit të lartë, angazhimin akademik si dhe në mësim dhe kërkime.
2. Universiteti do të ketë fuqinë e subjektit lidhur me dispozitat e këtij Statuti:

## Neni 9

1. Organet kryesore të Universitetit do të janë:
  - i. Këshilli i Përkohshëm Drejtues – Këshilli;
  - ii. Senati i përkohshëm; dhe
  - iii. Rektori themelues;

### Pjesa III: QEVERISJA

#### Këshilli i Përkokshëm Drejtues – Këshilli

##### Neni 10

1. Ministri i MASHT – it me vendim të posaçëm emeron anëtarët e Këshillit të Përkokshëm Drejtues (më tej, Këshilli).
2. Këshilli është organi kryesor qeverisës i Universitetit.
3. Këshilli do të këshillojë në çdo kohë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe të caktøjë, mbikëqyrë dhe mbështetë Rektorin themelues të Universitetit.
4. Këshilli do të ketë jo më pak se shtatë anëtarë dhe jo më shumë se nënlë.
  - 4.1 Rektori i Universitetit është anëtar i Bordit pa të drejtë vote.
  - 4.2 Drejtori i Departamentit të Arsimit të Lartë merr pjesë në takimet e Këshillit, por pa të drejtë vote.
5. Anëtarët e Këshillit emërojnë Kryetarin, Nënkyetarin dhe Sekretarin nga radha e anëtarëve të cilët janë të kualifikuar për zgjedhje në këto poste.

##### Neni 11

#### Këshilli i Përkokshëm Drejtues do të ketë përgjegjësitet vijuese:

1. Këshilli i Përkokshëm Drejtues, me propozimin e Senatit, planifikon karakterin arsimor dhe misionin e Universitetit. Nëse konsiderohet e nevojshme, konsultohen edhe ekspertët ndërkombëtarë.
2. përdorimin efektiv dhe të fritshëm të burimeve, vendit të Universitetit dhe sigurinë e vlerësimit në emër të publikut;
3. bën plane për sigurimin adekuat të burimeve që, duke i dhënë konsideratë të veçantë lehtësimeve të krijimit të kompanive subsidiare, të shfrytëzohet puna akademike në Universitet;
4. konsideron, nëse mendohet i përshtatshëm, aprosimin për parashtrim para autoriteteve civile të vlerësimit vjetor të të hyrave dhe shpenzimeve të përgatitura nga Rektori; dhe
5. cakton, vlerëson, gradon, rrit, pezullon, hedh poshtë dhe vendos për pagesën dhe kushtet e shërbimit të anëtarëve të stafit Detyrat e Këshillit do të janë si më poshtë;
6. mban shënimë të sakta mbi të hyrat dhe shpenzimet e Universitetit;
7. formulon skema për delegimin e autoritetit mbi burimet dhe çështjet tjera administrative te Fakultetet dhe njësitë tjera të Universitetit;
8. aranzhon kontrollin financier siç parashihet tani e tutje;
9. nxjerrë Vendime që kanë të bëjnë me
  - 9.1 drejtimin e stafit;
  - 9.2 procedurat për sigurimin e mundësisë së anëtarëve të stafit që të synojnë në ndreqjen (përmirësimin) apo në ankesë për të punësuarit e tyre;
  - 9.3 pezullimin ose shkarkimin e anëtarëve të stafit;
  - 9.4 ankesë kundër pezullimit apo shkarkimit
10. te nxjerrë vendime në lidhje me qeverisjen, drejtimin dne menaxhimin e Universitetit që mund të kërkohen me këtë Statut apo që mund të shihen si të dëshirueshme dhe konsistente;
11. të përkrahë dhe sigurojë se të gjitha palët e Universitetit përkrahen, të sigurojë mundësitet e barabarta për punësim dhe hyrjen e barabartë në studime dhe kërkime dhe

12 te vendosë për formën dhe përbajtjen e flamurit, vulës, simboleve dhe diplomës.

## Neni 12

### Zgjedhja dhe emërimi i Rektorit Themelues

1. Këshilli vendos që të shpallet konkurs publik për zgjedhjen e Rektorit Themelues;
2. Këshilli vendos per kushtet e përgjithshme dhe të veçanta që duhet t'i plotësojë një kandidat për Rektor Themelues;
3. Këshilli ka përgjegjesi që të vendose për procedurat teknike dhe agjendën e përzgjedhjes së kandidatëve të mundshëm per Rektor Themelues;
4. Kandidatët -- konkurrit kanë detyrim që para Këshillit të paragesin një ekspoze – interpelancë lidhur me synimet, vizionin dhe planet për zhvillimin e Universitetit;
5. Pas procedurës së përzgjedhjes dhe intervistimit të kandidatëve për Rektor Themelues. Këshilli do t'i propozojë Ministrit të Arsimit, Shkencës e Teknologjisë tre (3) kandidate për këtë detyrë;
6. Ministri i MASHT – it me vendim, emëron Rektorin Themelues;

### Rektori themelues

1. Rektori është drejtuesi kryesor (autoriteti kryesor menaxhues) i Universitetit.
2. Fillimi dhe mbarimi i mandatit të Rektorit Themelues caktohet në bazë të vendimit të Ministrit të MASHT – it
3. Rektori Themelues i përgjigjet Ministrit të MASHT – it dhe Këshillit për udhëheqje akademike dhe menaxhment efektiv, duke përfshirë menaxhimin financiar të Universitetit.
4. Këshilli duhet të vendosë nëse do ta miratojë këtë strukturë të propozuar të fakultetit brenda dy javëve të prezantimit të tij nga Rektori Themelues.

## Neni 13

### Rektori ka për detyrë :

1. Të veprojë në emër të Universitetit dhe ta përfaqësojë atë para publikut të gjërë;
2. Të organizojë, drejtojë dhe menaxhojë Universitetin;
3. Të udhëheq personelin;
4. Të vendosë për personelin e Universitetit në kuadër të kornizës së caktuar nga Këshilli;
5. Të punësojë, delegojë, nivelizojë, promovojë, suspendojë, shkarkojë dhe përcaktojë nivelin e pagave dhe kushteve të punës për personel në kuadër të kornizës së caktuar nga Këshilli,
6. Ta kryesojë Senatin,
7. Të paraqesë para Këshillit propozime ne lidhje me karakterin arsimor dhe misionin e Universitetit, duke marrë parasysh rekomandimet dhe mendimin e Senatit;
8. Të zbatojë vendimet e Këshillit;
9. Të menaxhojë buxhetin dhe mijetet në kuadër të shumës së miratuar nga Këshilli;
10. Ta përpillej raportin vjetor të kushtet përmes hyrës së shpanzurit përmesin nga Këshilli;
11. Të nënshkruajë kontrata në emër të Universitetit me palet e tretë;
12. Të nënshkruajë diplomat dhe certifikatat e tjera zyrtare të Universitetit.

13. Të propozojë kandidatët për postin e prorektoreve, për t'u zgjedhur nga Ministri i MASHT – it;
14. Të propozojë kandidatët per postin e sekretarit të përgjithshem;
15. Të shpallë të gjithë titujt akademikë;
16. Të kryejë të gjitha detyrat e tjera në emër të Universitetit, siç janë përcaktuar me këtë Statut apo me rregulloret e tjera në fuqi.

#### Neni 14

Rektori ka të drejtë të formoje komisione këshillëdhënëse të përkohshme të Rektoratit.

#### Neni 15

Autoriteti i Rektorit do të simbolizohet përmes gjerdanit të Rektorit.

#### Neni 16

1. Mandati i Rektorit mund të përfundojë para kohe në rast të :
  - a. Dorëheqjes
  - b. Shkarkimit nga detyra
  - c. Arsyeve shëndetësore
  - d. Dënimit për vepër penale
  - e. Vdekjes
2. Rektori mund të shkarkohet në çdo kohë nga Ministri i MASHT – it.
3. Procedurat për shkarkimin e Rektorit mund të iniciohen me shumicën absolute të votave nga Këshilli ose Senati.
4. Në rast të shkarkimit të Rektorit përfundon edhe mandati i prorektoreve.

#### Neni 17

Emërimi i Prorektorit dhe ushtruesve të detyrës së Dekanëve të Fakulteteve

1. Rektori i propozon ministrit të MASHT – it dy zëvendës – rektore, të cilëve mund t'u delegojë cilindë nga funksionet dhe kompetencat e tij;
2. Emërimi i zëvendësrektoreve duhet të miratohet nga ministri i MASHT – it;
3. Mandatet e Rektorit Themelues dhe Prorektorit do të jenë të harmonizuara;
4. Rektori Themelues do të emërojë një ushtrues detyre të dekanit për të udhëhequr çdo fakultet, i cili njihet si i tillë nga Këshilli i Përkohshem Diejtues me një mandat të kufizuar deri me e planit zhvillimor tre vjeçar;
5. Posa të miratohet Plani Zhvillimor nga Këshilli që dhetë pranohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Rektori Themelues shpall konkurs për postet e Dekanit të secilës fakultet të krijuar;
6. Konkursi për këto poste do të shpallet publikisht;
7. Paneli Emërues për postin e Dekanit të Fakultetit do të përbëhet nga Rektori, Prorektoret dhe

## Pjesa IV: Senati i përkohshëm

### Neni 18

Senati i përkohshëm (me tutje Senati) është organi më i lartë akademik i Universitetit. Senati do të përbëhet nga personal e mëposhlëm:

1. Rektori themelues
2. Prorektoret
3. U.D. Dekanët e Fakulteteve
4. U D. Drejtoret e njësive të tjera të aprovuara nga Këshilli
5. Një anëtar i zgjedhur nga stafi akademik në çdo Fakultet ose njësi tjetër ashtu që numri i personave në total të jetë i barabartë në tre (3) dhe katër (4)
6. Tre anëtarë të zgjedhur nga studentët
7. Një anëtar i zgjedhur nga stafi joakademik

### Neni 19

Rektori do ta kryesojë Senatin. Në mungesë të Rektorit, Prorektori do të merrë kryesimin.

### Neni 20

Në vartesi të përgjegjësive të përgjithshme të Këshillit, Rektorit dhe Prorektorëve, Senati do të jetë përgjegjës për:

1. Çështjet e përgjithshme strategjike që lidhen me kërkime, studime, mësimdhënie dhe kurset në Universitet, duke përfshirë:
  - a) kriteret për pranimin e studenteve;
  - b) emërimin e mësimdhënësve (personelin akademik);
  - c) politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe mbajtjen e provimeve për konstatimin e punës akademike të studenteve;
  - d) përbajtjen e planprogrameve;
  - e) sigurimin e mësimit gjatë gjithë jetës;
  - f) standartet akademike, validiletin dhe rishikimin e kurseve;
  - g) sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin;
  - h) procedurën për dhënen e kualifikimeve dhe titujve akademikë të nderit;
  - i) procedurën për përvijimin e studenteve për arsyen akademike apo të tjera;
2. Zhvillimin e strategjisë për aktivitetet akademike në Universitet dhe mjetet e nevojshme për t'i mbështetur ato, si dhe ofrimin e këshillave për Rektorin dhe Këshillin drejtues;
3. Zhvillimin e politikës së mbrojtjes së pronësisë intelektuale të Universitetit dhe shfrytëzimin komersial të saj;
4. Sigurimin e këshillave për çështje të tjera që Këshilli Drejtues ose Rektori mund të kërkojnë nga Senati.

## Neni 21

Detyrat e Senatit janë:

1. Te miratojë Statutin e Universitetit, pasi të jetë këshilluar me Këshillin drejtues;
2. Te zgjedhë dekanët sipas propozimeve të këshillave të njësive akademike përkatëse;
3. Te lëshojë vendime për pranimin dhe shuarjen e njësive akademike dhe të propozojë ndryshime të tjera në Statut të tyre për miratim nga ana e Këshillit;
4. Të miratojë programet e studimeve të njësive akademike;
5. Të përpilojë strategji për zhvillimin akademik të Universitetit;
6. Të nxjerrë vendime të përgjithshme për fushat e punës arsimore, kërkimore dhe artistike;
7. Të caktojë procedura dhe kriteret përvlerësimin e mësimdhënies, punës shkencore dhe artistike;
8. Të propozojë kriteret për regjistrimin e studentëve, në përputhje me këtë Statut;
9. Të vendojë kriteret përpjashlimin e studentëve;
10. Të definojë standarde akademike përligjérata dhe përsigurim të cilësisë së mësimeve, në pajtim me këtë Statut;
11. Të vendojë përkriteret e provimit;
12. Të përcaktojë përbajtjen e të gjitha të dhënavëve akademike dhe dokumentacionit sipas këtij Statuti;
13. Të vendojë procedurën përvlerësimin e personelit akademik në përputhje me këtë Statut;
14. Të zgjedhë anetarët përfundimtare duke i marrë parasysh kundërshtimet e dhëna nga këshillat e njësive akademike;
15. Të vendojë titullin Dr Honoris Causa;
16. Të vendojë titullin Profesor Emeritus sipas propozimit të njësisë akademike përkatëse;
17. Të vendojë titullin Anëtar Nderi i Universitetit;
18. Të shqyrtojë çështjet, me kërkesë të Këshillit apo Rektorit;
19. Të shqyrtojë çështjet, me kërkesë të Parlamentit të Studentëve;
20. Të shqyrtojë çështje të tjera siç përcaktohen nga ky Statut ose me kërkesën e Këshillit, Rektorit ose këshillave të fakulteteve.

## Neni 22

1. Senati mund të formoje këshilla ose komisione të përkohshme përfundimtare duke i marrë parasysh kundërshtimet e dhëna nga këshillat e njësive akademike;
2. Senati ka një komision të përhershëm, të quajtur Komisioni i Studimeve, sipas dispozitave të këtij Statuti.

## Pjesa e V: Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit

### Neni 23

1. Sekretari eshte zyrtari me fuqie ekzekutive dhe administrative i Universitetit, me të drejta që përgjegjesi të veçanta të përcaktuara në kontraten e tij, e cila nënshkruhet nga Rektori.

- 2 Sekretari i përgjigjet Rektorit për administrim efikas, ekonomik dhe efektiv në të gjilha nivelet e Universitetit. Në këtë pozitë Sekretari i Përgjithshëm përgjigjet për të gjilha çështjet që nuk janë kompetencë e organeve ose e udheheqësve tjere.
- 3 Sekretari i Universitetit është udheheqës i Administratës së Universitetit. Ai është udheheqës i Administratës Qendrore të Universitetit

#### Neni 24

- 1) Sekretari i Universitetit zgjedhet nga Këshilli Drejtues sipas propozimit të Rektorit, lë bazuar në konkursin publik.
- 2) Sekretari i përgjithshëm emërohet për një periudhë prej pesë vitesh, me mundësi lë riemërimit për një periudhë të pakufizuar.

#### Neni 25

Kandidatët që konkurrojnë për postin e Sekretarit të Universitetit duhet të përbushin këto kushte:

1. Të kenë diplomë universitare (master apo ekuivalente me më së paku shkallën e studimeve themelore);
2. Preferohen fushat profesionale nga drejtësia, ekonomia apo shkencat shoqërore;
3. Të kenë kualifikime dhe përvojën e duhur;
4. Të kenë aftësi lë dëshmuara organizative dhe menaxhuese;
5. Të kenë njoħuri tē mjaftueshme për proceset e arsimit, artit dhe kërkimeve;
6. Të kenë së paku pesë vjet përvojë pune në punë tē ngashme.

#### Neni 26

Sekretari i përgjithshëm i Universitetit ka këto delyra dhe përgjegjësi:

1. është zyrtari më i lartë i Administratës;
2. është udheheqës i Administratës Qendrore;
3. është shef i zyrave administrative dhe sekretarëve në fakultete;
- 4) është zyrtar përgjegjës për udheheqje efikase, ekonomike dhe efektive të Universitetit,
- 5) është përgjegjës për zhvillimin dhe mirëmbajjen e sistemeve informative të menaxhimit dhe për përgatitjen dhe organizimin e të dhënave për menaxhim;
6. është zyrtar përgjegjës për përgatitjen teknike lë procesit buxhetor;
7. është përgjegjës për çështje të tjera që kërkoher nga Këshilli Drejtues dhe Rektori, të cilat nuk janë tē percaktuara me këtë Statut

### Pjesa VI: Fakultetet

#### Neni 27

Fakulteti do të jetë njësi e Universitetit i ngarkuar me mesim në një fushë specifike ose fusha te subjekteve që do të jeto po ligjores, por së vjollë.

1. Ti bëjë propozime Senatit për çështjet akademike, që kanë të bëjnë me lëndet që ligjerohen ne Fakultet.

- 2 provimet dhe vlerësimet e studentëve;
- 3 çështjet në lidhje me progresin akademik të studentëve;
- 4 çështjet e kuadrove siç është e paraparë ne këtë Statut;
- 5 përdorimin e drejtë dhe efikas të pasurive të akorduara nga Këshilli.

#### Neni 28

Fakultetet e Universitetit Publik "Haxhi Zeka" në Pejë janë:

- 1 Fakulteti i Biznesit
- 2 Fakulteti Juridik
- 3 Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit
- 4 Fakulteti i Arteve të Bukura
- 5 Fakulteti i Agrobiznesit

#### Neni 29

Fakultet e sipërpërmendura duhet që, në përputhje me standardet për akreditim, të hartojnë dokumentacionin në mënyrë që në Agjencinë për Akreditim të Republikës së Kosovës të aplikojnë për akreditimin institucional edhe të programeve

#### Neni 30

Fakultetet e propozuara do të janë përgjegjëse për programet e emërtuara të studimit dhe fushat e kërkimit. Këto mund të janë lë një natyre njëdisiplinore apo ndërdisiplinore

#### Neni 31

Numri i ardhshëm i fakulteteve - departamenteve dhe pozita e stafit në çdo Fakultet do të vendoset nga Këshilli me propozimin e Senatit ose përndryshe pas konsultimeve me Senatin.

### U.D. Dekanët

#### Neni 32

Çdo Fakultet do të udhëhiqet nga U.D. Dekanit, i cili duhet t'i nënshtronhet aprovimit nga Këshilli, dhe do te ndihmohet nga një apo më shumë Prodekanë

#### Neni 33

1. U.D. Dekanet do te emroret nga Këshilli morëkomandante Rektori. Aka do te zgjedhen nga mesi i Profesorëve, që punojnë në Universitet dhe për periudhën jo më së shumti trevjeçare derisa të jetë në fuqi ky Statut

- 2 U.D. Prodekanet do të emërohen nga Keshilli sipas rekomandimit nga U.D. Dekani. Ata do të zgjedhen nga mesi i Profesorëve, që purojnë ne Universitet dhe për periudhen jo nië së shumti tregjeçare derisa të jetë në fuqi ky Statut
- 3 Kandidatët për zgjedhje në postin e Dekanit, Prodekanit duhet të kanë kualifikime relevante akademike, aftësi drejtuese dhe eksperience

#### Neni 34

Autoriteti i Dekanit është i simbolizuar me zinxhirin e Dekanit

#### Neni 35

Dekani do të jetë përgjegjës para Rektorit. Detyrat e Dekanit do të janë:

- 1 të ofrojë udheheqje akademike në subjeklet e fakultetit në mësim dhe kërkim;
- 2 të sigurojë përdorimin e frylshëm, ekonomik dhe efektiv të resurseve të vendosura në Fakultet nga Keshilli;
- 3 ta përfaqësojë Keshillin e Fakultetit në Senat,
- 4 ta këshillojë Rektorin dhe Keshillin mbi emërimin e anëtarit të stafit akademik që dërgohet nga Fakulteti;
- 5 të kujdeset për detyrat tjera të Dekanit që janë paraparë me këtë Statut.

#### Neni 36

Dekani mundet të veprojë në emër të Universitetit ose në çështje legale në emër të Fakultetit vetëm me aprovimin e shprehur të Keshillit me Rregullore ose ndryshe.

#### Neni 37

Detyrat e Prodekanit do të percaktohen nga Dekani

#### Neni 38

Çdo Fakultet do të ketë Keshillin, anëtarësia e të cilit do të jetë:

- 1 Dekani
- 2 Prodekanët
- 3 Profesorët e Fakultetit
- 4 Një numër të paraparë nga Senati, nga stafi tjeter akademik i zgjedhur dhe nga stafi i Fakultetit
- 5 Një përfaqësues i studentëve

#### Neni 39

Keshilli i Fakultetit do ta këshillojë dhe do t'i propozojë Dekanit për të gjitha çështjet që lidhen me Fakultetin dhe do të jetë përgjegjës për monitorimin e progresit të studentëve në Fakultet dhe për dhienien e rekondimeve për Senatin, permes Dekanit, për ndryshime në planprograme, metodën e mësimit dhe çështje tjera akademike. Ai duhet ta udhëheqë punën e tij në palimin e shumicës së votave.

#### Neni 40

Anetaret studentë të Këshillit të Fakultetit do të përjashtohen nga diskutimi që bëhet për studentët individualist ose për anetaret e stafit nëse këto konsiderohen të janë konfidenciale dhe në rastet kur eshte ne pyetje zgjedhja e mësimdhënësve ne thirrje akademike.

## Pjesa VIII: Njësitë tjera

### Neni 41

Numri dhe funksioni i njësive tjera të Universitetit do të vendoset nga Këshilli pas konsultimit me Senat. Njësitë ashtu si krijohen mund të shpërbehen ose bashkohen (shkrihen).

### Neni 42

Njësita ekzistuese në datën e aprovimit të ketij Statuti do të vazhdojnë të ekzistojnë derisa ndryshe nuk vendos Këshilli.

### Neni 43

Çdo njësi do të jetë pjesë integrale e Universitetit.

### Neni 44

Numri i departamenteve dhe pozita e stafit në çdo njësi do të vendoset nga Këshilli. Kur njësia ka funksion të mësimit ose kërkimeve ose vepron në mbështetje të këtyre funksioneve, Këshilli, pas konsultimit me Senatin, do të marrë vendim.

### Neni 45

Këshilli merr vendim per themelimin e: Qendres për Marredhëniet me Jashtë, Qendrës për Cilësi, Qendrës për Hulumtime dhe Kërkime Shoqërore – Ekonomike.

### Neni 46

Drejtori do të emërohet nga Këshilli ne bazë të rregullave për emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit.

### Neni 47

Drejtori do t'i përgjigjet Rektori. Detyrat e Drejtoris do te janë

- 1 te menaxhojë njësinë që te përdore frytshëm, ekonomikisht dhe efektivisht resurset e vendosura tek ai nga Këshilli;
- 2 nese lejohet nga Këshilli të përfaqësojë njësinë në Senat;
- 3 të keshillojë Rektorin dhe Këshillin mbi emërimin e anëtarëve të stafit ne njësi;
- 4 të kujdeset për detyrat tjera të Drejtoris të paraprua ne këtë Statut

## Pjesa IX: Pranimi i studentëve

Neni 48

Pranimi i studentëve do të qeveriset sipas instrukSIONEVE dhe legjislacionit të MASHT – it

## Pjesa X: Titujt (dhëniet) Akademikë

Neni 49

Universiteti pas akreditimit të programeve nga Agjencia e Akreditimit të Republikës së Kosovës do të ofrojë këtalitujakademikë:

1. Diplomë për studime themelore – Bachelor le Shkencave dhe Bachelor i Arteve
2. Diplomë Master Profesional (niveli i parë) dhe Master i Shkencave (niveli i dytë), dhe
3. Diplomë Doktorature

Neni 50

Titujt akademikë do t'i takojnë personelit akademik sipas dispozitave të këtij Statuti dhe mbajtësit e tituje munden që nga Këshilli, me rekomandimin e Senatit, për shkaqe të arsyeshme (good cause), pas dëgjimit, të privohen nga titujt e tyre. 'Shkak i arsyeshëm' nënkuplon mashtrim ose padrejtësi në provim, që shpie në ndonjë titull duke përfshirë edhe plagiaturë, shkelje e të drejtës së botimit ose ndonjë praktikë tjeter jo etike në përgatitjen e disertacionit ose ndonjë punimi tjeter i shkruar.

Neni 51

Studimet themelore për diplomë do të zgjasin së paku tri vite ose 180 ECTS.

Neni 52

Mënyra e vlerësimit të efektshmërisë së studentëve në studime bazike do të parashihet me Rregullore të veçantë të nxjerrë nga Senati.

Neni 53

Diploma e masterit do të arrihet pas kompletimit të suksesshëm të studimeve, kushteve, ECTS dhe mënyrave të caktuara me Programin Akademik i cili është akredituar nga Agjencia për Akreditim e Republikës së Kosovës.

Neni 54

Mënyra e vlerësimit të efektshmërisë së studentëve në studimet master do të parashihet menjë dokument të standardizuar, të nxjerrë nga Senati.

Neni 55

Pembajtja e programeve të studimeve per studime bazike dhe për titullin e masterit do të parashihet pasi që programi i mesimit të jetë i akredituar nga AKK dhe ne baze të Rregullores së përgatitur nga Fakulteti që aprovuar nga Senati.

## Pjesa XI: Stafi Akademik

### Neni 56

Stafi akademik i Universitetit do të perbhet nga

Profesorë të rregullt;

1. Profesorë të asocuar
2. Profesorë asistentë
3. Ligjëruesit
4. Lektorët
5. Asistentet mësimor
6. Asistentët të rinj
- 7.

Të gjitha këto pozita mund të mbahen me kontrata të plota ose me gjysmë orari.

### Neni 57

1. Profesorët e rregullt, Profesorët e Asocuar, Profesorët Asistent, Ligjëruesit dhe Lektorët pas konkursit publik dhe referateve të komisioneve recensuese do të zgjedhen nga Senati Akademik pas konsultimit me Fakultetin.
2. Asistentet mësimor dhe Asistentët e rinj pas konkursit publik dhe referateve të komisioneve recensuese do te zgjedhen nga Senati Akademik pas konsultimit me Fakultetin.

### Neni 58

1. Të gjitha propozimet për stafin akademik pas shqyrtimit të aplikacioneve nga Komisioni recensues, i emëruar nga Dekani, i dërgohen për miratim Senatit Akademik.
2. Kryetari i Komisionit Recensues ose Dekani do t'i raportojë Këshillit të Fakultetit lidhur me propozimin e Komisionit Recensues.

### Neni 59

Për kërkesat për caktimin dhe promovimin e çdo grade të stafit akademik, aplikanti duhet të ketë kualifikimin e përshtatshëm dhe eksperiencën relevante për post:

#### 1. Për titullin e Profesorit të Rregullt aplikanti duhet:

- a. të mbajë se paku gradën e Doktorit të Shkencave (PhD) ose ekivalente me të,
- b. të demonstroje nivel të lartë të njohurive dhe dijes për subjektin;
- c. të deshmoje cilësi dhe metodologji në mësimdhënien;
- d. të ketë vlerë e pakë se këtu se paku 10 publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike;
- e. pjesëmarrja të vazhdueshme në konferenca të rendësishme ndërkombëtare,
- f. të ketë përvjoe në punë akademike.

- g. të deshmojë punë dijetari (scholarly work), dhe
- h. aktivitetë tjera dhe evidence e dukshme e udhëheqjes akademike.

2. Për titullin Profesor i Asocuar aplikanti duhet:

- a. të mbajë së paku gradën Doktor i Shkencave (PhD) ose ekivalente me të;
- b. në katër vitet e fundit të ketë së paku 6 publikime në revistat shkencore ose artistike nderkombëtare;
- c. pjesëmarrje të vazhdueshme ne konferanca të rëndësishme nderkombëtare;
- d. të ketë krijuar punime artistike ose prezantime publike;
- e. të ketë demonstruar aftesi të mira ne mësimdhënie universitare;
- f. të deshmojë punë dijetari (scholarly work), dhe
- g. mjeshteri në lëndën e lëmise përkate.

3. Për titullin Profesor Asistent kandidati duhet :

- a. të mbajë së paku gradën Doktor i Shkencave (PhD) ose ekivalente me të;
- b. të ketë së paku 2 publikime në revistat shkencore ose artistike nderkombëtare;
- c. të ketë krijuar punime artistike ose prezantime publike;
- d. të ketë demonstruar aftesi të mira ne mësimdhënie;
- e. të deshmojë punë dijetari (scholarly work), dhe
- f. mjeshteri në lëndën e lëmës përkate.

4. Për titullin e Ligjëruesit kandidati duhet:

- a. të demonstroje aftesi të mira ne mësimdhënie;
- b. të deshmojë punë dijetari (scholarly work), e dëshmuar me posedimin e titullit të magjistraturës ose masterit;
- c. të jetë i regjistruar për shkallën e doktoraturës, dhe
- d. të ketë dëshmi per angazhimin në sferën e punës hulumtuese -- shkencore;

5. Kandidati për Lektor duhet:

- a. të demonstroje aftesi të mira ne mësimdhënie;
- b. të deshmojë punë dijetari (scholarly work), e dëshmuar me posedimin e titullit të magjistraturës ose masterit, dhe
- c. të ketë dëshmi për angazhimin në sferën e punës hulumtuese – shkencore;

6. Për titullin e Asistentit Mësimor kandidati duhet:

- a. të tregohet kompetent ne mësimdhënie ose kërkime, respektivisht të ketë përvojën e duhur akademike.
- b. të ketë notë mesatare të studimeve themelore ose ekivalente me to jo më poshtë se 8,
- c. të ketë të regjistruarë studimet e doktoraturës,
- d. të ketë angazhime fillosteare ne fushen publicistike, hulumtuese dhe kërkimore – shkencore, dhe
- e. kur të zgjidhet për herë të parë të jetë me i ri / re se 35 vite.

7. Për titullin e Asistentit i ri kandidati duhet:

- f te tregohet kompetent në mësimdhene ose kërkime;
- g te ketë notë mesatare te studimeve themelore ose ekivalente me to jo më poshtë se 8. dhe
- h kur te zojdhet për here të pare të jetë më i ri / re se 25 vite.

Neni 60

Të gjithë emeruarit do të caklohen mbi bazën e meritave akademike pa diskriminim të asnjë grupi siç janë: gjinia, gjendja martesore, ngjyra, gjuha, religioni, opinioni politik ose tjetër, origjina sociale ose etnike, asociacioni me komunitetet nacionale, pasuria, lindja ose statuset tjera.

Neni 61

1. Të gjitha emerimet për gradën Profesor, Profesor i Asocuar, Profesor Asistent ose Lektor do të mbahen për një periudhë fillestare prej katër (4) vitesh, të cilat mund të përsëriten nga Senati Akademik me rekomandimin e Këshillit të Fakultetit.
2. Ligjërueshit do të emerohen për një periudhë fillestare prej tri (3) vite, e cila mund të përsëritet nga Senati Akademik me rekomandimin e Këshillit të Fakultetit.
3. Ligjëruesi mund të rizgjedhet vetëm një herë edhe për një afat prej dy (2) vitesh dhe pas afatit prej pesë (5) vitesh nuk ka mundësi të rizgjedhet në asnjë thirrje respektivisht të fitojë gradë akademike ligjërues.
4. Procedura e rizgjedhjes është e ngjashme me atë të zgjedhjes.

Neni 62

Krejt stafit do të pensionohet kur të mbërrijë moshën 65 vite. Profesorët e pensionuar mund të caklohen nga Senati Akademik në pozitën e Profesorit Emiritues. Detyrat e Profesorit Emiritues do të parashihen në kontraten individuale.

Neni 63

Skema për "vitet e lira të studimit" (leja per shkëputje) do të parashihet nga Këshilli pas konsultimeve me Senatin.

Neni 64

Asnjë anëtar i stafit i emeruar në pozitë të plotë nuk mund të ndërmerrë asnjë punë jashtë Universitetit, perfshirë punën për kompanitë publike ose private ose organizata apo tjetër universitet ose institucione të arsimit të lartë brenda ose jashtë Kosovës, pa lejen e Këshillit. Në dhënen e lejes Këshillit do të caktoje kushtet sipas lirise së tij (diskrecionit).

## Pjesa XII: Të drejtat dhe obligimet e studentëve

### Neni 65

Studentët të cilët janë të pranuar në Universitet kane të drejtë:

1. të marrin pjesë në të gjitha ligjërata, seminaret dhe organizimet tjera të mësimit të organizuara ne fushen e tyre sipas pozitës së tyre;
2. të përdorin pajisjet e Bibliotekës së Universitetit dhe shërbimeve tjera për student;
3. të marrin pjesë në zgjedhjet për pozitat e studentëve në organet e Universitetit;
4. të montorojnë, respektojnë Vendimet e nxjerra nga Universiteti;
5. të kenë lidhje të përshtatshme me të drejtat e slafit dhe studentëve tjere;
6. të kenë vëmendje të plotë për studimet e tyre dhe të participojnë në aktivitetet akademike;
7. të drejtojnë vetylën, në dhe jashtë hapësirës universitare, ashtu që të mos e diskreditojnë Universitetin

### Neni 66

Studentët kane të drejtë të ankohen mbi cilësinë e mësimit ose pajisjeve të Universitetit. Ankesat e tillë fillimisht i bëhen Dekanit ose udhëheqësit ekuivalent me apel te Senati, vendimi i të cilit do të jetë final. Rregulloret që elaborojnë këto procedura do të nxirren nga Bordi me propozimin e Senatit.

### Neni 67

Studentët mund të hiqen nga regjistrimi nga Këshilli i Fakultetit për dëshrimin që të bëjnë progres adekuat në studimet e tyre, sipas vlerësimit në fushën akademike nga Profesori relevant. Një apel mund t'i behet Senatit ose Komitetit të emeruar nga Senati, vendini i të cilit do të jetë final (perfundimtar). Rregulloret që elaborojnë këtë proceduri do të nxirren nga Bordi me propozimin e Senatit.

### Neni 68

1. Studentët për shkelje të rregulloreve dhe etikës mund të përjashtohen nga Universiteti përgjithmone ose përkohësisht nga Senati. Studentët e akuzuar për sjellje të keqe kanë të drejtë të dëgjohen nga Komisioni Disiplinor i cili do ta këshillojë Senatin.
2. Studentët e përjashtuar nga ana e Senatit mund te apelojnë te Bordi, i cili mund të konfirmojë ose hedh poshtë vendimin e Senatit.
3. Rregulloret që elaborojnë këto procedura do të nxirren nga Bordi me propozimin e Senatit.

## Pjesa XIV: Të dhënat (shënimet)

### Neni 74

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit do te jetë përgjegjës për të mbajtur të dhëna të rregullta për:

- a) aplikantët për pranim
- b) dokumentet e studentëve për të gjitha programet e studimeve dhe kërkimeve
- c) diplomat
- d) stafin nën kontratë
- e) pasurinë
- f) llogaritë financiare
- 8. f.1 kontratat e kërkimeve dhe konsultative
- 9. f. 2 kontratat komerciale
- 10. f. 3 çështje tjera që kërkohen nga Këshilli

### Neni 75

Gjithë stafi dhe studentët e Universitetit duhet të kooperojnë me Sekretarin e Universitetit që t'i ofrojnë informata që kërkohen të mbahen sipas nenit paraprak.

### Neni 76

Të gjitha të dhënat lidhur me personat do të mbahen, duke respektuar natyrën private dhe do të hapen vetëm për qëllime te kërkura nga ligji dhe ky Statut.

## Pjesa XV: Shërbimet administrative dhe profesionale

### Neni 77

1. Shërbimet profesionale dhe administrative të Universitetit përbëhen nga departamentet, që i përgjigjen Sekretarit të Përgjithshëm si në vazhdim:
  - a. Sekretariati (duke përfshirë Shërbimin juridik dhe Shërbimet e sekretarisë, Arkivi, Zyrën për marrëdhënie me publikun, Zyrën për menaxhimin e cilësisë, Zyrën për marrëdhënie ndërkombetare, Shërbimin e prokurimit, Shërbimin e përkthimit dhe interpretimit, Shërbimin e auditimit të brendshëm)
2. Shërbimet profesionale brenda Universitetit janë:
  - a. Departamenti i Shërbimit të Financave
  - b. Departamenti i Shërbimit Studentor dhe Registrimit
  - c. Departamenti i Përimave Njëzore dhe Zhvillimit të Stafit
  - d. Departamenti i Shërbimit TI
  - e. Departamenti i Informimit dhe Shërbimeve Bibliotekare

3. Sekretari i përgjithshëm do të krijojë një strukturë organizative, të aprovuar nga Rektori dhe Këshilli i Universitetit, të përbërë nga personel me përvojë që do t'i ndihmojnë atij dhe do të jene njekohësisht përgjegjës për uchheqjen dhe menaxhimin e atij staf;
4. Struktura organizative ose administrata e Universitetit do të funksionojë e përbashkët për të gjitha njësítet akademike dhe njësítet tjera në mënyrën më bashkëkohore, duke zbatuar teknologjite me të perparuara të informacionit - digitalizimin total;

## Pjesa XVI: Organizatat e stafit dhe studentëve

### Neni 78

Stafi ka të drejtën e tubimit paqësor dhe të drejtën të formojë sindikalën ose asociacionin e stafit që t'i përfaqësojë interesat e tyre kolektive tek autoritetet e Universitetit dhe për qëllime tjera të parapara me ligj.

### Neni 79

Të gjithë studentët duhet të jenë anëtarë të Organizatës së Studentëve.

### Neni 80

Organizata e Studentëve do të ketë Statutin e vet të aprovuar nga anëtarët e saj dhe Bordi. Statuti duhet të përfshijë përimet e mundësive të barabarta dhe jodiskriminimin.

### Neni 81

Një Asamble e anëtarëve duhet të jetë trup suprem vendimmarrës i Organizatës së Studentëve.

### Neni 82

Organizata e Studentëve e themeluar në pajtim me këtë pjesë do të zgjedhë në mënyrë të lirë dhe të drejtë përfaqësuesit për në Senat dhe organet tjera, që janë parashikuar me këtë Statut, dhe të veprojë në emrin e vet në relacionet me autoritetet e Universitetit.

### Neni 83

Studentet kanë të drejtën e tubimit paqësor.

### Neni 84

Studentet kanë të drejtë të formojnë asociacione ose shoqëri per çdo qëllim të pranuar me ligj.

## Pjesa XVII: Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare

### Neni 85

Senati, Këshilli i Fakultetit do të vazhdojne sikur që janë të konstituuar më së largu deri më 31 Shtator 2014.

### Neni 86

1. Këshilli dhe Kryetari i Këshillit është përgjegjës që t'i përmbushë të gjitha detyrimet statutore, që i takojnë Senatit dhe Rektorit Themelues derisa këto organe të formohen konform me dispozitat e këtij Statuti.
2. Deri në konstituimin e të gjitha organeve të parapara me Statut, të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Rektorit në themelim me vendim të Këshillit të Përkohshëm Drejtues dhe me miratimin paraprak të Ministrit transferohen te Kryetari i Këshillit Drejtues.
3. Personat që mbajnë emërimet në ditën e aprovimit të këtij Statuti në pozitën e Rektorit Themelues, Prorektorëve, U.D. Sekretarit, U.D. Dekanëve dhe U.D. Prodekanëve në Universitet do të vazhdojnë me emërimet e tyre derisa Këshilli lë vendosë ndryshe.
4. Të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me Universitetin mund të ndërpritet në momentin kur Këshilli me pëlgirmin e Ministril të MASHT - it hartojnë Statutin e ri, i cili miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
5. Me hyrjen ne fuqi të Statutit të ri të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ky akt juridik pushon të veprojë menjehere.

### Neni 87

Ministri i MASHT - it vet ose përmes Këshillit te Përkohshëm Drejtues, pas hyrjes në fuqi të këtij Statutit te përkohshëm, sa më shpejt që është e realizueshme duhet:

1. të parashikojë datat për zgjedhjen dhe emërimin e Rektorit Themelues, Senatit dhe organeve tjera të parapara në këtë Statut dhe emërimet e parapara në nenin e mësipërm, kështu që Këshilli, Senati dhe organet e tjera do të rikonstituohen më së largu deri me 1 qershor 2012;
2. të autorizojë Këshillin për procedurën për rishikim të establishmentit të stafit sipas provizioneve të këtij Statuti;
3. të autorizojë Këshillin për procedura për krijimin e Organizatës së Studentëve dhe zgjedhjen e përfaqësueseve të saj.

### Neni 88

Çdo praktikë ekzistuese nga Universiteti i Prishtinës, që nuk është në kundërshtim me këtë Statut, do të jetë e pranueshme deri më 01 tetor 2012, nese ndryshe nuk vendoset nga Këshilli.

Studentët ekzistues të Universitetit do të mbajnë programet e studimit për të cilat ata janë regjistruar dhe sicas rregulloreve akademike apo tjera të nxjerra dhe të autorizuara që të vazhdojnë sipas këtij Statutit.

Neni 92

Të gjitha procedurat për shkëputje nga Universitetit i Prishtinës do të bartën në përgjegjësinë e Këshillit Drejtues.

Neni 93

Ky Statut hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga ana e Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Prishtinë, 06/01/2011



Ramë Buja, Ministër i MASHT